



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.233 Akti

Nr. 258 Vendimi
Tiranë, më 12.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Lici, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 4 qershor 2020, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gjon Fusha**, me detyrë prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, me detyrë prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.11.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin. Me vendimin nr.17, të datës 9.3.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos zëvendësimi për arsye objektive i anëtares së trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, me komisioneren Pamela Qirko, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me këtë subjekt. Subjekti i rivlerësimit u njoh në datën 9.3.2020 me ndryshimin e anëtares dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtares, komisioneren Pamela Qirko. Me vendimin nr. 3, datë 9.3.2020, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ, për t’i dhënë kohën e nevojshme anëtarit zëvendësues të njohet me dosjen. Në datën 26.3.2020 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP).

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018.

të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Gjon P. Fusha.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 26.2.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gjon Fusha, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, z. Gjon Fusha i janë garantuar të drejtat, si: të njoftohet për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 26.2.2020, për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dha 7 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Z. Gjon Fusha, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 5.3.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 2.6.2020.

Seanca dëgjimore u zhvilluan në datat 4.6.2020, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. *** , datë 27.9.2018, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Gjon Fusha ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gjon Fusha, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, është bërë subjekt deklarues në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe dhe deklarata “Vetting”).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën e pasurisë sipas formularit (shtojca nr. 2) të datës 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar këto pasuri:

1. Automjet tip “M”, vit prodhimi 1994, blerë në vitin 2005

Pjesa në përqindje: 100 %.

Vlera e deklaruar: 2.000 euro dhe vlera e zhdoganimit në shumën 338.730 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhura të siguruara nga emigracioni në Greqi dhe të ardhura të siguruara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes.

Deklarimi në DPV: subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 blerjen e këtij automjeti. Për herë të parë ky automjet është deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

DPSHTR⁴-ja informon në lidhje me automjetin me targa GJ *** A, në pronësi të z. Gjon Fusha, bashkëlidhur faturë blerje automjeti datë 25.5.2005. Vlera e blerjes: 2.000 euro.

Analiza financiare

Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë që kishte subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar, bazohet në:

- të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, të lëshuara nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten;
- shpenzimet, ku u morën në konsideratë si vijojnë: shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së; shpenzimet për udhëtimet jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht,

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019.

lëvizjet hyrje - dalje nëpërmjet sistemit *TIMS*, për subjektin e rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit; shpenzimet e mobilimit u bazuan në deklaratimet e subjektit;

- analizën ku janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

Përshkrimi	2005
PASURI	674 286
Automjet	583 810
DIFERENCË LIKUIDITETI	90 476
LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)	90 476
DETYRIME	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	674 286
TË ARDHURA	1 284 702
Të ardhura subjekti	890 120
Të ardhura bashkëshortja	394 582
SHPENZIME	416 243
Shpenzime jetese	328 671
Shpenzime qiraje	60 000
Shpenzime udhëtimi	27 572
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	90 476
Llogari e subjektit, “Raiffeisen Bank” (lekë)	80 350
Llogari e znj. A. Fusha, “Raiffeisen Bank” (lekë)	10 126
Rezultati	194 173

Nga analizimi i të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortes për vitin 2005 ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti me të ardhurat e vitit përkatës, referuar analizës financiare.

Nga verifikimi i deklaratimeve periodike vjetore evidentohet se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 blerjen e këtij automjeti. Për herë të parë ky automjet është deklaruar në deklaratën “Vetting”. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet nga Komisioni

Në prapësimet e rezultateve të hetimit, të depozituara nga subjekti në datën 5.3.2020, subjekti ka shpjeguar se ka qenë një harresë problemi i mospërfshirjes së blerjes së makinës në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005. Subjekti ka argumentuar se konstatimi i Komisionit është i drejtë, por përderisa veprimet në regjistrin publik pranë DRSHTRR-së Gjirokastër, që nga data e regjistrimit dhe periodikisht për çdo vit e deri më sot janë kryer prej tij, kjo provon se nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër dhe automjeti është përdorur vazhdimisht nga subjekti dhe bashkëshortja.

Analiza e provave dhe arsyetimi ligjor

Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, nisur nga fakti që subjekti e ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën “Vetting”, fakti që kjo pasuri ka qenë e regjistruar në regjistrat publikë, si dhe referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, ku sipas saj subjekti e justifikon blerjen me burime të ligjshme, të gjitha këto të dhëna tregojnë se subjekti nuk ka pasur si qëllim të fshehtë këtë pasuri.

Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë automjet në deklaratën “Vetting” dhe ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e saj, në përputhje me ligjin.

2. Subjekti zotëron 16.6 % të pasurisë (truall + ndërtesë) me sip. 440 m², me nr. **, ndodhur në z. k. *, Tiranë**

Burimi i krijimit: pasuri e përfutur me vendimin nr. ***, datë 23.1.2017, “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore”, subjekti është një prej 6 trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit P. Gj. Fusha.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. **, datë 21.12.2004, pasuria nr. ** z. k. ***, truall me sip. 440 m², mbi të cilin janë ndërtuar ndërtesat, shtëpi një kat nr. **, shtesa e dhomës 3.4 x 3.2 m, në shtëpinë nr. **, katër dhoma në shtëpinë nr. **, shtesat anësore (dhomë me përmasa 4 x 2.10 m² 5.2 x 1.9 m²); vendim për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. **, datë 23.1.2017 (njehsuar me origjinalin me vërtetim nr. * prot., datë 27.1.2017).

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁵, ka konfirmuar se në emër të shtetasit P. Gj. Fusha (babai i subjektit) figuron e regjistruar pasuria truall me sip. 487 m² + ndërtesë me sip. 252 m², nr. pasurie **, z. K***, vol. ** f. **, në bashkëpronësi me një person tjetër.

Dokumentacioni i depozituar për këtë pasuri:

- kartela e pasurisë, për truall me sip. 487 m² + ndërtesë me sip. 252 m² në emër të shtetasve D. F dhe P. F, në bashkëpronësi;
- urdhër i ZVRPP-së Tiranë me nr.*** prot., datë 23.1.2012, ku përshkruhet se pasuria me nr. **, regjistruar në vol. **, f. **, z. k. ***, nëpërmjet VKKP-së nr. ***, datë. 27.12.1994, i është kthyer ish-pronarëve një sipërfaqe truall prej 440 m². Gjendja faktike e pronës rezulton me sip. 487 m². Për sa më sipër, titullari ka urdhëruar pasqyrimin në hartat treguese të gjendjes faktike të truallit të pasurisë nr. **. Mbi këtë sipërfaqe ka ndërtime, të cilat i janë kthyer pronarit me VKKP, si dhe kufizimin e saj deri në zgjidhjen e diferencës së sipërfaqes së truallit dokument-fakt nga organet kompetente;
- vërtetim nga dokumenti hipotekor për këtë pasuri në emër të shtetasve D dhe P.Fusha, i lëshuar në datën 30.5.2005, sipas të cilit rezulton se znj. D. F disponon 1/6 e pasurisë, ndërsa z. P. Fusha disponon 5/6 e kësaj pasurie;
- vendimi Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me nr. ***, datë 27.12.1994, sipas të cilit, z. Gj. Fusha (*gjyshin e subjektit*) njihet si ish-pronar i pronës. Komisioni ka njohur pronësinë mbi truallin dhe ndërtesën + shtesat e trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit Gjon Fusha. Kjo pronë figuronte e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. **, datë 21.5.1948.

Subjekti ka depozituar aktin noterial nr. ***, datë 23.1.2017, për “Lëshimin e dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore”. Sipas këtij akti, subjekti është një prej 6 trashëgimtarëve ligjorë të

⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019.

babait të tij, të cilët trashëgojnë secili në mënyrë të barabartë 1/6 pjesë të të gjitha pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Nga aktet e administruara në dosje nuk rezulton që dëshmia e trashëgimisë ligjore të jetë depozituar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për t'u regjistruar përfituesit e rinj të kësaj pasurie.

Analiza e provave

Trupi gjykues, pas analizimit të akteve të depozituara për këtë pasuri, ka konstatuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, përputhet me dokumentacionin e administruar.

3. Kredi në shumën 1.000.000 lekë, në datën 14.6.2011, në “Raiffeisen Bank” (dega Gjirokastër), me afat 84 muaj dhe kësti mujor në shumën 18.740 lekë

Në lidhje me kredinë e marrë, subjekti ka shpjeguar se për arsye shëndetësore, pasi ka pësuar hemorragji cerebrale dhe kolegët kanë mundësuar dërgimin e tij për kurim në Janinë, Greqi, bashkëshortja (me cilësinë e kredimarrëses) ka marrë kredi në “Raiffeisen Bank”. Subjekti, që prej datës 14.6.2011 deri më 29.6.2011, është trajtuar në spitalin universitar të Janinës.

Për shpenzimet e kurimit, subjektin e kanë ndihmuar motrat në Greqi, motra e bashkëshortes në SHBA, shokët dhe kolegët (prokurorë dhe gjyqtarë) dhe pas daljes nga spitali, në datën 4.7.2011, bashkëshortja ka shlyer kredinë e mësipërme të papërdorur.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë kredie bankare datë 14.6.2011, për shumën 1.000.000 lekë me qëllim “arsye personale” në “Raiffeisen Bank”;
- faturë arkëtimi nga znj. A. F në datën 4.7.2011, shuma 974.000 lekë dhe në datën 5.7.2011, shuma 32.000 lekë, me përshkrimin “derdhje në llogari për shlyerje kredie nga “Raiffeisen Bank”.

Subjekti ka deklaruar se për shpenzimet e kurimit e kanë ndihmuar motrat e tij në Greqi, motra e bashkëshortes në SHBA, shokët dhe kolegët (prokurorë e gjyqtarë), pas daljes nga spitali. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokument që të provojë shumat e dhuruara nga motrat në Greqi, shokët dhe kolegët prokurorë e gjyqtarë, sipas deklarimeve të tij, duke i kërkuar në prapësime të dokumentojë shumat e dhuruara.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

“Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2019, konfirmon se shtetasja A. F ka qenë kredimarrëse pranë bankës për kredinë e marrë në datën 4.6.2011, në shumën 1.000.000 lekë, e mbyllur më 5.7.2011.

Në llogarinë personale në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortes së subjektit janë evidentuar depozitime të shumave:

- 700 USD, shumë e cila është dërguar nga motra e bashkëshortes së subjektit, znj. E. D (S), rezidente në SHBA, si ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së subjektit e tërhequr nga MoneyGram, datë 19.7.2011;
- 2.000 USD, shumë e cila është dërguar nga vëllai i bashkëshortes, z.A. S, rezident në SHBA, e tërhequr nga MoneyGram, datë 16.10.2012;
- 1.000 USD, shumë e cila është dërguar nga vëllai i bashkëshortes, z.A. S, rezident në SHBA, për lindjen e djalit datë 13.8.2013. Kjo shumë është tërhequr nga MoneyGram, datë 9.7.2013.

Subjekti, për secilën nga tërheqjet e mësipërme, i ka bashkëlidhur deklaratës, si më poshtë:

- modularin e tërheqjes nga MoneyGram në “Raiffeisen Bank”, datë 19.7.2011, në shumën 700 USD, dërguar nga E. D., bashkëlidhur faturë tërheqje e shumës 700 USD me dërgues E. D, SHBA. Faturë depozitimi në llogarinë personale të znj. A. F, për shumë 700 USD, datë 19.7.2011;
- modulari i tërheqjes nga MoneyGram në “Raiffeisen Bank”, datë 16.10.2012 për shumën 2.000 USD, dërguar nga A. S., bashkëlidhur faturë tërheqje e shumës 2000 USD, me dërgues A. S, SHBA. Faturë depozitimi në llogarinë personale të znj. A. F, për shumën 2.000 USD, datë 16.10.2012;
- modulari i tërheqjes nga MoneyGram, në “Raiffeisen Bank”, datë 9.7.2013, për shumën 1.000 USD, dërguar nga A. S., bashkëlidhur faturë tërheqje e shumës 1.000 USD, me dërgues A. S, SHBA. Faturë depozitimi në llogarinë personale të znj. A. F, për shumën 1.000 USD, datë 9.7.2013.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësime të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se shpenzimet e kurimit sipas faturës së depozituar prej tij janë në shumën 1.231 euro: *“Një pjesë e personave të afërm dhe kolegë më kanë vizituar dhe ndihmuar me rastin e përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, bashkëlidhur dhe për referencë të deklaratimeve, kam depozituar disa deklarata noteriale. Secila prej dhuratave nuk ka qenë në vlerën e detyrueshme për t’u deklaruar si e tillë, gjithashtu, kredia fillimisht u mor për çdo rast, pa e ditur se sa mund të ishin shpenzimet e kurimit dhe në momentin që gjithçka përfundoi, sipas referimit në faturën që unë kam bashkëlidhur dokumenteve, nuk ishte e nevojshme që të shtoja detyrimet e mia edhe për interesin e kredisë, prandaj ajo u kthye”*.

Analiza e provave dhe fakteve

Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionin mbështetës të depozituar prej tij, Komisioni arsyeton se shpenzimet spitalore për kurimin, në shumën 1.231 euro, janë mbuluar me ndihmat e ofruara nga familjarët, të provuara me dokumentacionin bankar të administruar në dosje.

Trupi gjykues ka konsideruar të pranueshme shpjegimet e subjektit, të shoqëruara me dokumentacion justifikues ligjor.

4. Gjendje në llogarinë rrjedhëse (paga) në “Raiffeisen Bank”, në shumën 504.715 lekë, të bashkëshortes së subjektit, znj. A. F

Burimi i krijimit: Kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” (dega Gjirokastër), në shumën 550.000 lekë, me afat 18 muaj dhe këst mujor prej 32.251 lekësh, kredi e cila është shlyer në datën 27.10.2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni

“Raiffeisen Bank”⁶ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të znj. A. F, me gjendje në datën 30.1.2017, shumën prej 504.215,13 lekësh.

“Raiffeisen Bank”⁷ ka konfirmuar se znj. A. F ka qenë kredimarrëse pranë bankës për kredinë e marrë datë 27.4.2015, në shumën 550.000 lekë. Kjo kredi është mbyllur në datën 27.10.2016.

Analiza e provave

⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2019.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”. Referuar analizës financiare ka rezultuar se subjekti kishte burime të ligjshme financiare për shlyerjen e kredisë.

5. Banesa në përdorim të deklaruara nga subjekti

- Pasuri në përdorim “apartament me qira” nga shtetasi S. M, ndodhur ne lagjen “**Shtatori”, Gjirokastër, me nr. **, z. k. **, kundrejt pagesës 12.000 lekë/muaj për periudhën qershor 2010 – 30.7.2013. Apartamenti është përdorur në bazë të një marrëveshjeje verbale dhe sot shtetasi i mësipërm ndodhet në Greqi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ** datë 31.5.2004. Pasuria me sip. 87 m², me nr. **, z. k. **, Gjirokastër, në pronësi të z. S. M. Bashkëlidhur hartë treguese, fletë nga regjistri i ZVRPP-së, Indeks Alfabetik.
- Pasuri në përdorim “apartament me qira” nga shtetasi P. V, në adresën: lagjja “18 Shtatori”, Gjirokastër me nr. pasurie **, z. k. **, kundrejt vlerës 15.000 lekë/muaj për periudhën 30.7.2013 – 4.2.2016. Subjekti ka deklaruar se pagesa është bërë në bazë të një marrëveshjeje verbale dhe në datën 4.2.2016 është përpiluar deklarata noteriale nr. **

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- aktmarrëveshjen datë 30.7.2013 midis shtetasve P.V (qiradhënës) dhe Gjon Fusha (qiramarrës). Çmimi i qirasë 15.000 lekë/muaj;
- deklaratë noteriale nr. **, datë 4.2.2016, midis shtetasve P. V dhe Gjon Fusha, me objekt: “dhënie me qira pasuri e patundshme, e ndodhur në lagjen “18 Shtatori” Gjirokastër, me sip. 90 m², z. k. **, në pronësi të shtetasit P. V. Kohëzgjatja: 5 vjet kundrejt çmimit 15.000 lekë/muaj;
- vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. **, datë 5.11.2014, apartament me sip. 108 m², në pronësi të shtetasit P.V.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër⁸, informon se nga verifikimi manual për subjektin dhe personat e lidhur nuk figuron pasuri e paluajtshme e regjistruar pranë regjistrimit fillestar Gjirokastër. Nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, subjektet e sipërcituara nuk rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit. Zyra nuk garanton faktin që këta shtetas mund të kenë pasuri të regjistruara në sistem apo në regjistrim të veçantë.

Në lidhje me banesat në përdorim, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore ka rezultuar se subjekti ka deklaruar:

- adresën “** Shtatori” Gjirokastër, si adresë banimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 (për herë të parë), në vitet 2004, 2005, 2006, 2008, 2011, 2013, 2015, 2016;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti ka deklaruar adresë banimi “** Shtatori”, p. **, ap. **, në hyrje të spitalit rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër;
- në deklaratën “Vetting” ka deklaruar adresë banimi: Njësia Administrative Gjirokastër nr. **, pallati afër spitalit “Omer Nishani”, Bashkia Gjirokastër.

Në lidhje me adresat e banimit për periudhën 2003 – 2010, subjektit i është kërkuar të deklarojë shpenzimin mujor, nëse ka përdorur banesa me qira, si dhe të depozitojë dokumentacionin provues (kopje të kontratave). Subjekti ka shpjeguar⁹ se për periudhën 2003 – qershor 2010 ka

⁸Me shkresën nr. ** prot., datë 24.10.2019.

⁹ Në përgjigjet e pyetësorit të dates 13.12.2019.

jetuar me qira me familjen në apartamentin në pronësi të z. G. Muhameti, me të cilin nuk ka pasur kontratë qiraje të nënshkruar, por ka pasur një marrëveshje verbale me kunatin e tij, i cili jetonte në Greqi. Pagesa mujore e qirasë për periudhën kohore 2003 – 2006 ka qenë 5.000 lekë; më pas, gjatë periudhës 2006 – qershor 2010 qiraja mujore ka qenë 10.000 lekë. Në periudhën korrik 2010 – korrik 2013, subjekti ka jetuar me familjen në apartamentin në pronësi të z. S. Mato, i cili jetonte në Greqi. Qiraja mujore ka qenë 15.000 lekë, për të cilën nuk ka pasur kontratë të nënshkruar, pasi edhe këtu marrëdhëniet i ka pasur me kunatin e tij dhe ka qenë një marrëveshje verbale.

Analizimi i provave

Referuar rrethanave dhe fakteve sa më sipër, nuk u ngritën dyshime mbi këto pasuri të përdorura nga subjekti i rivlerësimit. Shpenzimet për banim, deklaruar nga subjekti, janë përfshirë në analizën financiare.

6. Depozitë në “Raiffeisen Bank” në emër të vajzës së subjektit, D. Fusha, krijuar në datën 25.5.2011, me gjendje në datën 23.1.2017, në shumën 25.927 lekë.

Subjekti ka deklaruar se si burim për këtë depozitë kanë shërbyer të ardhurat nga paga e bashkëshortes në vlerën 5.000 lekë/muaj, për periudhën 25.5.2011 – 15.6.2015.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

7. Depozitë në “Raiffeisen Bank”, në emër të djalit të subjektit, P. Fusha, krijuar në datën 25.5.2011 dhe me gjendje në datën 23.1.2017, në shumën 125.841 lekë.

Subjekti ka deklaruar se si burim për këtë depozitë kanë shërbyer të ardhurat e tij nga paga në vlerën 5.000 lekë në muaj, për periudhat 25.5.2011 – 8.6.2012 dhe 17.6.2013 – 15.6.2015.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, “Raiffeisen Bank”¹⁰, ka konfirmuar:

- Ilogari rrjedhëse në emër të vajzës, znj. D. Fusha, me gjendje në datën 30.1.2017, shumën 5.002,95 lekë;
- Ilogari rrjedhëse në emër të djalit, z. P. Fusha, me gjendje në datën 30.1.2017, shumën 5.002,95 lekë.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

8. Dëmshpërblim për automjetin me targa GJ *** A, në shumën 97.000 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin e datës 21.10.2016, të lëshuar nga shoqëria “S U. G. A”, për kompensimin e dëmit të automjetit me targa GJ *** A, në shumën 97.000 lekë.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar, lëshuar nga shoqëria “S. U. G. A” sh.a.

9. Dhuratë shuma prej 100.000 lekësh nga babai i bashkëshortes, z. N. Sinani, e depozituar për llogarinë e znj. A. Fusha, në “Raiffeisen Bank”, datë 11.9.2015

Komisioni hetoi për mundësinë financiare të dhuruesit. Nga verifikimi i llogarive bankare në emër të dhuruesit, ka rezultuar se ky shtetas ka përfutur të ardhura nga kompensimi i një

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

pasurie, të cilat janë depozituar në llogarinë e tij bankare. Z. N. Sinani ka pasur mundësi financiare për dhurimin me shumë 100.000 lekë në favor të vajzës së tij.

Nga hetimi i Komisionit rezulton se subjekti ka dokumentuar burimet e ligjshme të dhuruesit për shumën e dhuruar prej 100.000 lekësh, në përputhje me pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

10. Deklarimi i të ardhurave

a) Të ardhurat e subjektit

- Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë, në periudhën 1.2.2000 – 1.1.2001. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë, në datën 13.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 299.293 lekë.
- Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë, në periudhën 1.1.2001 – 30.4.2003. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë, në datën 13.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 1.272.869 lekë.
- Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, në periudhën 1.5.2003 – 3.6.2015. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë në datën 13.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 12.178.108 lekë.
- Prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Gjirokastrë, në periudhën 4.6.2015 – 31.12.2016 Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë në datën 10.1.2017 (dy fletë). Vërtetimi me nr. ** prot., datë 26.1.2017, një fletë, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 1.952.714 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga trajtimi për paaftësi të përkohshme në punë (raporte mjekësore) për periudhat: 27.6.2011 – 10.12.2011, pagesë e përfituar në vlerën 379.553 lekë; 10.6.2014 – 23.9.2014, pagesë e përfituar në vlerën 258.595 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i DRSSH-së, Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 24.10.2016 (dy fletë). Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 638.148 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara prej tij, subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar në total, shumën 16.341.132 lekë.

b) Të ardhurat e bashkëshortes

- Bashkëshortja A. Fusha, juriste në Këshillin e Qarkut, Gjirokastrë, në periudhën 17.2.2001 – 2017 ka përfituar të ardhura nga paga në vlerën 6.281.028 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, në datën 25.1.2017. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 6.281.028 lekë.
- Bashkëshortja A. Fusha, specialiste e jashtme në Bashkinë Libohovë, periudha kohore janar 2010 – dhjetor 2013. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Libohovë, datë 24.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 778.968 lekë.
- Bashkëshortja A. Fusha, specialiste e jashtme në Komunën Qendër Libohovë, periudha kohore janar 2010 – dhjetor 2013. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Libohovë, datë 24.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 406.316 lekë.

- Bashkëshortja A. Fusha, anëtare e njësisë së prokurimit, viti 2009 (për shkak të profesionit) në Komunën Qendër Libohovë. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Libohovë, datë 24.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton 36.000 lekë.
- Bashkëshortja A. Fusha, punonjëse e jashtme në Bashkinë Memaliaj ka përfituar të ardhura për vitin 2016, në vlerën 207.792 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Memaliaj, datë 25.1.2017.
- Bashkëshortja A. Fusha, specialiste e jashtme (licencuar në fushën e prokurimeve) pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, korrik 2014. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, në datë 24.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton: 9.000 lekë.
- Bashkëshortja A. Fusha, specialiste e jashtme (licencuar në fushën e prokurimeve) pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka përfituar të ardhura: për vitin 2012, në vlerën 20.000 lekë; për vitin 2013, në vlerën 9.900 lekë; për vitin 2014, në vlerën 18.000 lekë; për vitin 2015, në vlerën 20.400 lekë, në total 68.300 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, datë 24.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton: 68.300 lekë.
- Bashkëshortja A.Fusha, anëtare e njësisë së prokurimit në “Ujësjetllës Kanalizime” Gjirokastrë, ka përfituar të ardhura për periudhat kohore: tetor 2012, në vlerën 24.300 lekë; qershor 2013, në vlerën 24.300 lekë; nëntor 2013, në vlerën 24.500 lekë dhe korrik 2014, në vlerën 24.300 lekë. Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga “Ujësjetllës Kanalizime” Gjirokastrë, datë 21.10.2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton: 95.400 lekë.
- Bashkëshortja A.Fusha, të ardhura të përfituara nga trajtimi për paaftësi të përkohshme në punë (barrë lindje) për periudhën 6.11.2007 – 17.3.2008, pagesa e përfituar në vlerën 138.608 lekë.
- Bashkëlidhje vërtetimi i DRSSH-së Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 24.10.2016.

Subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar si të ardhura të përfituara nga bashkëshortja, në total shumë 8.422.464 lekë.

Analizimi i provave

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar vërehet se deklarimi i subjektit për të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes përputhen me dokumentacionin e lëshuar nga institucionet përkatëse.

11. Detyrime financiare

Subjekti ka deklaruar huamarrje (*overdraft*) nga “Raiffeisen Bank”, në vlerën 47.250 lekë. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”¹¹ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të subjektit, me gjendje në datën 30.1.2017, shumë - 4.124 lekë, për shkak të *overdraft*-it të përdorur.

Nga verifikimi i të dhënave të ardhura nga banka rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

¹¹ Me shkresën nr. ** prot., datë 4.10.2019.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR MBI PASURINË

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë, nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin, duke pasur burime të ligjshme për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Grupi i Punës në DSIK, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka konstatuar papërshtatshmëri¹² në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha.

Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me figurën

Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme për procedime të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Fusha, e cila informon se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda¹³ Tiranë, në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie, nuk rezulton që në emër të shtetasit Gjon Fusha të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndaj këtij shtetasi është regjistruar kallëzimi me nr. **, i vitit 2015, i cili lidhet me procedimin penal nr. **, i vitit 2015, për nenin 319/ç. Pas hetimeve të kryera për këtë procedim penal është vendosur pushimi i çështjes në datën 30.7.2015.

Analizimi i provave

Nga verifikimi i akteve të dosjes rezulton se në Prokurorinë për Krimet e Rënda Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç.

Referimi për procedimin penal nr. ***, të vitit 2015 është bërë nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar në Policinë e Shtetit. Pas kryerjes së veprimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në datën 30.7.2015, në bazë të nenit 328 germa “b”, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2015.

Nga aktet e dosjes ka rezultuar se prokurori i çështjes ka vendosur regjistrimin e procedimit penal në datën 10.2.2018, referuar nenit 287, të Kodit të Procedurave Penale “... *emri i personit që i atribuohet vepra penale shënohet në të njëjtën kohë me regjistrimin e veprës penale, ose dhe më vonë*”. Në këtë rast, prokurori i çështjes nuk ka regjistruar emër personi të cilit i atribuohet vepra penale as në momentin e regjistrimit të procedimit penal, por as më vonë. Gjatë fazës së hetimit paraprak, në analizë të provave, prokurori i çështjes nuk i ka dhënë shtetasit Gjon Fusha as cilësinë e personit nën hetim dhe as të të pandehurit.

Referuar akteve të dosjes që i përkasin procedimit penal nr. *** për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni

¹² Ritheksojmë që DSIK-ja, në raportin paraprak të padeklasifikuar, nuk ka konstatuar përshtatshmërinë për subjektin e rivlerësimit, z. Gjon Fusha, por papërshtatshmërinë.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019.

319/ç, kjo çështje është regjistruar pa autor konkret, pa paragjykuar se çfarë do të rezultonte nga hetimet dhe cili do të individualizohej si autor i veprës penale. Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, nuk është marrë në asnjë moment në cilësinë e personit nën hetim dhe nuk është marrë si i pandehur.

Pas analizimit të provave dhe fakteve në dosjen penale, prokurori i çështjes në datën 30.7.2015, ka vendosur të pushojë procedimit penal nr. ** të vitit 2015 për arsye të mungesës së provave për ekzistencën e veprës penale të korrupsionit parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Komisioni ka konstatuar se për faktin se subjekti Gjon Fusha nuk është marrë as si person nën hetim, as si i pandehur, nuk ka pasur detyrimin të deklarojë këtë fakt as në formularin për pastërtinë e figurës.

Arsyetimi ligjor

Komisioni ka vlerësuar se referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk ka qenë as i dënuar, as i proceduar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në krimin e organizuar, gjithashtu, rezulton se subjekti ka plotësuar formularin për kontrollin e figurës në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit.

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Komisioni ka kryer një hetim të thellë për subjektin e rivlerësimit, duke marrë shkas nga *indiciet* e dërguara nga DSIK-ja. Nga informacioni i ardhur në Komision, referuar raportit të DSIK-së sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.12.2019¹⁴, ka rezultuar:

“...për subjektin e rivlerësimit, z. Gjon Fusha, disponohen të dhëna të viteve 2011 dhe 2016, ... ku ngrihen dyshime se mund të jetë përfshirë në veprimtari korruptive në një çështje penale, në Prokurorinë e PRRGJ-së, Gjirokastër...”

“...për z. Gjon P. Fusha, disponohen të dhëna të vitit 2019, të cilat sinjalizojnë mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv”.

Referuar këtij informacioni, Komisioni ka kërkuar pranë Prokurorisë së Apelit Gjirokastër dosjet penale të regjistruara në ngarkim të shtetasve L. K., dhe A. L.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër¹⁵ ka depozituar dy dosje penale, nga analizimi i akteve ka rezultuar:

- Për shtetasin me inicialet L. K.:

Nga verifikimet e akteve rezulton se në datën 29.4.2019, shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Sarandë kanë siguruar një informacion se shtetasi me inicialet L. K., do të transportonte lëndë narkotike nga ish-Komuna Ksamil për në Sarandë. Pas ndjekjes nga policia dhe aksionit të tyre për ndalimin e personave të dyshuar, u kapën disa shtetas.

Mbi bazën e provave të mbledhura nga policia, organi i akuzës i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me një kërkesë me objekt: *“vlerësim i ligjshëm i arrestimit dhe caktimit si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim, shtetasit me inicialet L. K., etj., atë të arrestit në burg”*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale.

Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, me vendimin penal nr. [***], datë 3.5.2019, ndër të tjera, ka vendosur:

¹⁴Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 27.12.2019.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.12.2019.

1. Vlerësim i ligjshëm i arrestimit të personit nën hetim, shtetasit me inicialet L. K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.
2. Caktim i masës së sigurimit personal kundër personit nën hetim, shtetasit me inicialet L. K., atë të arrestit në burg, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale.

Kundër këtij vendimi penal kanë ushtruar ankim të dyshuarit e mësipërm, nëpërmjet mbrojtësve të zgjedhur prej tyre:

I dyshuari, shtetasi me inicialet L. K., ka kërkuar ndryshimin e pjesëshëm të vendimit penal të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për sa i përket llojit të masës së sigurimit të vendosur nga gjykata, “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale, me masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurave Penale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Gjon Fusha, ka konsideruar të drejtë vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (arrest në burg) dhe ka kërkuar në gjykim miratimin e vendimit penal nr. ***, datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 21.5.2019, ka vendosur miratimin e vendimit penal nr. *** datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Analizimi i provave

Komisioni, pasi verifikoi dhe analizoi aktet e dosjes penale, konkludon se nuk dokumentohet asnjë veprim nga subjekti i rivlerësimit, i cili të konsiderohet si favorizues ndaj të pandehurit, shtetasit me inicialet L. K.

- Për shtetasin me inicialet A. L.:

Nga verifikimi i akteve nga Komisioni vërehet se:

Për shtetasin A. L. rezulton një procedim penal i regjistruar, pasi në datën 9.1.2015, është njoftuar salla operative e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë se dy shtetas të panjohur, në qendër të lagjes “Punëtore” i kanë vjedhur me dhunë çantën të dëmtuarës, shtetas me inicialet S. V., brenda së cilës ishin shumat 1.000 euro dhe 5.000 lekë dhe janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Në kallëzimin e datës së mësipërme, e dëmtuara me inicialet S. V., ka shpjeguar se rreth orës 03:00, të datës 9.1.2015, është kthyer nga Greqia dhe autobusi pas mbërritjes në Gjirokastrë ka ndaluar te rrethrotullimi i lagjes “Punëtore”.

E dëmtuara ka shpjeguar se dy persona, që zbritën prej një automjeti ngjyrë të kuqe, kanë shkuar në drejtim të saj dhe të të afërmeve. Njëri nga personat, pikërisht ai që ndodhej më afër të dëmtuarës, i ka kapur dhe rrëmbyer me dhunë çantën që mbante në krah, duke ia tërhequr me forcë dhe pasi ia ka marrë është larguar me vrap.

Në përfundim të hetimeve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin penal nr.*** ndër të tjera, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurve me inicialet E. Sh., dhe E. H.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L., për kryerjen e veprës penale “moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300 dhe germa “ç” e nenit 48, të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurave Penale, i pandehuri dënohet përfundimisht me 8 muaj burgim.

Ndaj vendimit penal të mësipërm kanë ushtruar ankim të pandehurit E. Sh., dhe E. H., të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për sa i përket masës së dënimit të dhënë, duke kërkuar uljen e dënimit, si dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Shtetasi me inicialet A. L., nuk ka depozituar ankim për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, sipas të cilit u dënua me 8 muaj burgim.

Prokuroria e Apelit Gjirokastrë, përfaqësuar në gjykim nga subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, ka kërkuar për këtë procedim:

Lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 19.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me të pandehur shtetasit: E. Sh., dhe E. H., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje me dhunë, kryer në bashkëpunim”, të parashikuar nga neni 139-25 i Kodit Penal dhe shtetasi me inicialet A. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim të krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Nga verifikimi i të dy procedimeve penale, atij në ngarkim të shtetasit me inicialet L. K., dhe të shtetasit A. L., subjekti i rivlerësimit ka kërkuar lënien në fuqi/miratimin e vendimit të Gjykatave të Rretheve Gjirokastrë dhe Sarandë.

Për këto arsye, nuk ka të dhëna e prova që të provonin se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar personat e përfshirë në këto procedime, sipas referimeve të DSIK-së. Në rastin e shtetasit A. L., ky i fundit nuk e ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë, për pasojë nuk duket se subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime favorizuese në ushtrimin e detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Në lidhje me çështjet penale të trajtuara më sipër, trupi gjykues vendosi t’i dërgojë për inspektim të mëtejshëm, pranë organit kompetent ILD, konkretisht, dosjet gjyqësore, si më poshtë:

1. dosjen që i përket vendimit penal nr. ***, datë 16.10.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sipas të cilit është vendosur miratimi i vendimit penal nr. ***, datë 19.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që i përkasin të pandehurit me inicialet A. L., etj.;
2. dosjen që i përket vendimit penal nr. *** datë 21.5.2019, i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sipas të cilit është vendosur miratimi i vendimit penal nr. ***, datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që i përkasin të pandehurit me inicialet L. K., etj.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është bërë nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme¹⁶, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Raporti është bazuar në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

¹⁶Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 -76, të ligjit nr. 96/2016.

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënave nga burimet arkivore të prokurorisë/ve.

Të dhënat arkivore

Referuar të dhënave arkivore pranë sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për prokurorin subjekt rivlerësimi, z. Gjon Fusha, rezulton se nuk ka masa disiplinore.

Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 subjekti Gjon Fusha është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi dhe shpejtësi.

Analiza e gjetjeve¹⁷

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga gjetjet në grupet e burimeve të informacionit, për periudhën e vlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, rezulton se nga vlerësimet e punës së subjektit Gjon Fusha, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu edhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve, që ka pasur në ndjekje.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Gjon Fusha, shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Gjithashtu, është konstatuar se subjekti identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet për zbatimin e saj në rastin konkret.

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, shfaq aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e provave dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë dhe përpiluar vendime e akte të kuptueshme, me tekst të qartë.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në tri aktet e dorëzuara dhe në pesë dosjet e shortuara për subjektin Gjon Fusha, konstatohet se subjekti shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e qartë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar

¹⁷Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 – 76, të ligjit nr. 96/2016.

në pjesën arsyetuese është e qartë dhe e kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazën ligjore. Subjekti respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, për periudhën e rivlerësimit për afro dhjetë muaj ka qenë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe për këtë arsye është spikatur dhe është vlerësuar për aftësi shumë të mira drejtuese. Më konkretisht ka rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhrave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punën e secilit prokuror. Gjithashtu, ka drejtuar punën për vlerësimin e punës së prokurorëve, sipas parashikimeve të rregullores përkatëse, si dhe ka bërë planifikim të saktë të ndarjes së punës të prokurorët e stafit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Gjon Fusha ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ka kryer hetime, ka drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm, në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve, ndërkohë që këto fakte janë prezantuar edhe në vlerësimin përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, vlerësim i cili për këto vite ka qenë “*shumë mirë*”.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Prokurori, subjekt rivlerësimi, z. Gjon Fusha, rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga subjekti është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe e burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim. Për sa i takon vendimmarrjes, subjekti është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse, ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara edhe në vlerësimet e bëra nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “*shumë mirë*”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori Gjon Fusha ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, të rregullsisë së akteve dhe të mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë nga prokurori Gjon Fusha, rezulton se janë përmbushur me korrektësi kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara, për efekt të procesit të rivlerësimit, konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin e duhur të akteve ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Gjon Fusha, dhe nga aktet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia*

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin e rivlerësimit, z. Gjon Fusha, për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe të papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar, apo të jenë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces, apo të grupeve shoqërore vulnerabël. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në tri dokumentet ligjore, si dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

Subjekti ka cilësi të mira bashkëpunuese, tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur aftësi dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

Rivlerësimi i aftësisë profesionale

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLP-ja;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe i pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin e tij, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Komisioni, në tërësi, vërejtë se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor në vendimmarrjet e tij, si dhe ruan normat etiko-profesionale.

Në lidhje me denoncimet nga publiku

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, janë depozituar 10 denoncime, nga të cilat 6 nga i njëjti shtetas. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e depozituara për subjektin e rivlerësimit dhe pasi kreu verifikimet përkatëse referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional, si dhe nuk rezultuan shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nga verifikimi i denoncimeve nuk u konstatuan *indicie* për veprime korruptive apo kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Relatorja e çështjes, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, fakteve publike, denoncimeve dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoi se subjekti i

rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është *eficient* dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurorit Gjon Fusha, sipas parashikimeve të nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është *eficient* dhe efektiv në masë të pranueshme dhe përfundimisht u propozua “i aftë”.

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Fusha, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Fusha, me detyrë prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
2. Të transferojë për inspektim pranë organit kompetent ILD dosjet gjyqësore, si më poshtë:
 - i. dosjen që i përket vendimit penal nr. ***, datë 16.10.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, sipas të cilit është vendosur miratimi i vendimit penal nr. *** datë 19.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që i përkasin të pandehurit me inicialet A. L., etj;
 - ii. dosjen që i përket vendimit penal nr. *** datë 21.5.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër sipas të cilit është vendosur miratimi i vendimit penal nr. ***, datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, që i përkasin të pandehurit me inicialet L. K., etj.
3. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.6.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)

Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Lici